



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) NR.20/2024 PËR EDUKIMIN, TRAJNIMIN DHE
NJOHJEN E SHËRBIMEVE DHE EKSPERTËVE**

Rregullorja (QRK) Nr.20/2024 për edukimin trajnimin dhe njohjen e shërbimeve dhe ekspertëve, është miratuar në Mbledhjen e 216-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/216, të datës 14.08.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore (Gazeta Zyrtare Nr. 5 dt. 27 prill 2018), nenit 10 të Ligjit Nr. 08/L-123 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive Ekzekutive (Gazeta Zyrtare Nr. 11 dt. 17 maj 2023), nenit 8 paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/22 e datës 18 nëntor 2022), si dhe nenin 78 paragrafi 6 nën-paragrafi 2 të Rregullores Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë

Miraton:

RREGULLORE (QRK) NR.20/2024 PËR EDUKIMIN, TRAJNIMIN DHE NJOHJEN E SHËRBIMEVE DHE EKSPERTËVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe procedurave për edukimin, trajnimin dhe njohjen e shërbimeve dhe ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore.
2. Rregullorja është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2013/59 për Standardet Bazë të Sigurisë për Mbrojtjen nga Rreziqet që vijnë nga Ekspozimi ndaj Rrezatimit.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për edukimin, trajnimin dhe njohjen e shërbimeve dhe ekspertëve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Njohja** – akt administrativ me të cilën i njihet e drejta e një shërbimi apo eksperti për kryerjen e ekspertizave në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi;
 - 1.2. **Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (DMRrSB)** – Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore ish Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;

1.3. **Ministria** – Ministria përkatëse për Mjedis;

1.4. **Autorizim** – regjistrimi ose licencimi i një praktike;

1.5. **Shërbim teknik** - organizata e cila ka burime teknike dhe njerëzore, njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose për të dhënë këshilla të mbrojtjes nga rrezatimi sipas kësaj Rregulloreje;

1.6. **Ekspert i fizikës mjekësore** - individin i cili ka njohuri, trajnim dhe përvojë për të vepruar ose dhënë këshilla mbi çështjet që lidhen me fizikën e rrezatimit të zbatuar në ekspozimin mjekësor, kompetenca e të cilit në këtë drejtim është njohur nga Ministria;

1.7. **Ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi** - individin i cili ka njohuri, trajnim dhe përvojë të nevojshme për të dhënë këshilla të mbrojtjes nga rrezatimi për të siguruar mbrojtjen efektive të individëve, kompetenca e të cilit në këtë aspekt njihet nga Ministria;

1.8. **Ekspozim** - akti i ekspozimit ose gjendjes së të qenit i/e ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues të emetuar jashtë trupit (ekspozim i jashtëm) ose brenda trupit (ekspozim i brendshëm);

1.9. **Ekspozim aksidental** - ekspozimi i individëve, më përjashtim të punonjësve të emergjencës, si rezultat i një aksidenti;

1.10. **Ekspozim emergjent në punë** - ekspozimi ndaj rrezatimit në një situatë emergjente të ekspozimit nga një punonjës emergjence;

1.11. **Ekspozim mjekësor** - ekspozimi i shkaktuar te pacientët ose individët asimptomatikë si pjesë e vetë diagnostikimit ose trajtimit të tyre mjekësor ose dentar, dhe në të mirën e shëndetit të tyre, si dhe ekspozimi i shkaktuar te kujdestarët dhe ndihmuesit si dhe nga vullnetarët në hulumtimet mjekësore ose biomjekësore;

1.12. **Ekspozim normal** - ekspozimi që pritet të ndodhë në kushte normale të operimit në një objekt ose aktivitet (përfshirë mirëmbajtjen, inspektimin, dekomisionimin) duke përfshirë incidente të vogla që mund të mbahen nën kontroll, pra gjatë operimit normal dhe ngjarjeve të parashikuara operative;

1.13. **Ekspozim profesional** - ekspozimi i punonjësve, praktikantëve dhe studentëve, të shkaktuar gjatë kryerjes së punës së tyre;

1.14. **Ekspozim publik** - ekspozimi i individëve, duke përjashtuar çdo ekspozim profesional apo mjekësor;

1.15. **Ekspozim i mundshëm** - ekspozimi që nuk pritet por mund të rezultojë nga një ngjarje apo sekuencë e ngjarjeve, duke përfshirë prishjen e pajisjeve ose gabimet gjatë punës;

1.16. **Ekspozimi në situatë ekzistuese** - një situatë e ekspozimit e cila ekziston në kohën kur duhet të merret një vendim për kontrollin e saj dhe e cila nuk kërkon që të merren masa urgjente;

1.17. **Ekspozim në situatë emergjente** –një situatë ekspozimi për shkak të një emergjence;

1.18. **Licencë** - leja e dhënë përmes një dokumenti nga Ministria për të ushtruar një praktikë në përputhshmëri me kushtet specifike të theksuara në atë dokument;

1.19. **Ndërmarrje** – person fizik apo juridik që ka përgjegjësi ligjore sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e një praktike, ka përgjegjësi ligjore për një burim të rrezatimit, ose operon me instalimet bërthamore, përfshirë rastet kur pronari apo mbajtësi i burimit të rrezatimit nuk kryen aktivitete njerëzore të ndërlidhura;

1.20. **Mbetje radioaktive** – materiali radioaktiv në formë të gaztë, të lëngët ose të ngurtë, përdorimi i mëtejshëm i të cilit nuk parashihet apo konsiderohet nga Ministria ose nga një person fizik ose juridik, i cili rregullohet si mbetje radioaktive në këtë Rregullore;

1.21. **Njoftim** - dorëzimi i informacionit te Ministria në mënyrë që të njoftojë për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve brenda fushëveprimit të kësaj Rregulloreje;

1.22. **Praktikant** - personin i cili është duke marrë trajnime apo udhëzime brenda një ndërmarrjeje me qëllim të ushtrimit të një aftësie të veçantë;

1.23. **Punonjës i ekspozuar** – personi, i vetëpunësuar ose që punon për një punëdhënës, i cili i nënshtrohet ekspozimit në punë të kryera brenda një praktike të rregulluar me këtë Rregullore dhe i cili mund të pranojë doza që tejkalojnë një ose kufijtë e tjerë të dozës për ekspozimin publik;

1.24. **Punonjës i jashtëm** - çdo punonjës të ekspozuar, i cili nuk është i punësuar nga ndërmarrja përgjegjëse për zonat e mbikëqyrura dhe të kontrolluara, por kryen veprimtari në këto fusha, duke përfshirë praktikantët dhe studentët;

1.25. **Rrezatim jonizues** - energjia e transferuar në formë të grimcave ose të valëve elektromagnetike të një gjatësie valore prej njëqind (100) nanometrash ose më pak, e aftë për të prodhuar jone në mënyrë direkte ose indirekte;

1.26. **Rrezatim jo-jonizues** – entiteti fizik që bart ose ruan energjinë në hapësirë dhe që ushtron forcë mbi ngarkesat elektrike. FEM-ja përfshin fushat magnetike, elektrike ose statike, me frekuenca në intervalin 0-300 GHz;

1.27. **Regjistrim** - autorizimi nga Ministria, me procedurë të thjeshtuar, për të ushtruar një praktikë në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi ose të përcaktuar nga Ministria për këtë lloj ose kategori të praktikës;

1.28. **Protokoll** – procedurë e shkruar për të përcaktuar dhe garantuar sigurinë dhe kujdesin optimal gjatë punës me burime radioaktive, transportit, magazinimit dhe trajtimit të pacienteve;

1.29. **Shërbim dozimetrik** - organizata kompetente për të bërë kalibrimin, leximin dhe interpretimin e pajisjeve të monitorimit individual, ose për të bërë matjet e radioaktivitetit në trupin e njeriut ose në mostrat biologjike, ose për të bërë vlerësimin e dozave, kompetenca e së cilës njihet nga Ministria;

1.30. **Burim i mbyllur** – burimi radioaktiv në të cilin materiali radioaktiv është i mbyllur përgjithmonë në një kapsulë ose i përfshirë në një formë solide me qëllim të parandalimit të çfarëdo shpërndarjeje të substancave radioaktive në kushte normale të përdorimit;

1.31. **Burim i hapur** - burimi radioaktiv në të cilin materiali radioaktiv nuk është i mbyllur në një kapsulë.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me shprehjet e përdorura në Ligjin Nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore.

3. Në kuptim të kësaj Rregullore emrat e gjinisë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat e gjinisë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim.

KAPITULLI II

KRITERET PËR NJOHJEN E SHËRBIMEVE

Neni 4

Vlerësimi i masave mbrojtëse nga rrezatimi

Vlerësimi i masave mbrojtëse nga rrezatimi kryhet nga shërbimet teknike, shërbimi i mjekësisë së punës dhe shërbimi i dozimetrisë të njohura nga Ministria – Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore.

Neni 5

Aktivitetet profesionale

1. Aktivitetet profesionale në mbrojtjen nga rrezatimi për të cilat kërkohet njohje janë:

1.1. Matja e rrezatimit personal të jashtëm ose të brendshëm të punonjësve të ekspozuar apo të individëve të cilët janë duke u trajnuar ose edukuar për të punuar me burimet e rrezatimit;

1.2. Kalibrimi, leximi dhe interpretimi i pajisjeve të monitorimit individual, matjet e radioaktivitetit në trupin e njeriut ose në mostrat biologjike, dhe vlerësimin e dozave;

1.3. Testimi i gjeneratorëve me rreze X, përsheptuesve, pajisjeve të tjera që prodhojnë rrezatim, si dhe dhënien e vlerësimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut në bazë të matjes dhe llogaritjes;

1.4. Testimi i burimeve të mbyllura radioaktive, pajisjeve dhe dhënia e vlerësimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut në bazë të matjeve dhe llogaritjeve;

1.5. Testimi i burimeve të hapura radioaktive, pajisjeve dhe dhënia e vlerësimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut në bazë të matjeve dhe llogaritjeve;

1.6. Kontrolli sistematik shëndetësor i punonjësve të ekspozuar sipas legjislacionit në fuqi;

1.7. Ekspertiza e burimeve të rrezatimit jonizues dhe hapësirave përreth, përgatitja e dokumenteve të cilat tregojnë përputhshmërinë e hapësirës me kushtet e parapara për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues;

1.8. Ekspertiza e burimeve të rrezatimit jo-jonizues dhe hapësirave përreth, përgatitjes së dokumenteve të cilat tregojnë përputhshmërinë e hapësirës me kushtet e parapara për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues;

1.9. Matjet dhe monitorimi i aktivitetit të substancave radioaktive në ajër, tokë, ujë duke përfshirë edhe ujërat nëntokësore, reshjeve, ujit të pijshëm, ushqimit, materialit ndërtimor dhe produkteve tjera që kërkohet;

1.10. Matja e përqendrimit të radonit dhe pasardhësve të radonit në ajër, ujë dhe tokë;

1.11. Transporti i burimeve, mbetjeve dhe materialeve radioaktive dhe bërthamore;

1.12. Paketimi i mbetjeve radioaktive dhe materialeve bërthamore për transport dhe magazinim;

1.13. Matja e dozës ekuivalente të ambientit;

1.14. Matja e rrezatimit alfa, beta apo gama për të cilin është kërkuar autorizimi;

1.15. Edukimi, trajnimi për punonjës profesional të ekspozuar, praktikantët dhe studentët;

1.16. Kalibrimi i pajisjeve në laborator sekondar standard dozimetrik;

1.17. Kontrollimi i skrap metalit për qëllime transport-eksporti.

Neni 6

Kriteret për njohjen e shërbimeve

1. Për tu njohur si shërbim për kryerjen e detyrave përkatëse të mbrojtjes nga rrezatimi, personi juridik duhet plotësuar kriteret si në vijim:

1.1. Të jetë i regjistruar në ARBK si biznes për kryerjen e veprimtarive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, ndërsa për institucionet publike sipas legjislacionit në fuqi;

1.2. Listën e eksperteve për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertëve të fizikës mjekësore, sipas praktikave për të cilat kërkohet licenca, se paku dy (2) ekspert të fushës përkatëse .

1.3. Të siguroj për punonjësit të cilët punojnë me burime të rrezatimit, matjen e rrezatimit personal (dosimetri personale), mbikëqyrje mjekësore dhe trajnim të veçantë profesional për zbatimin e masave për mbrojtje nga rrezatimi;

1.4. Të ketë hapësirë pune në pronësi, e cila lejon të kryejnë detyrat për të cilat është kërkuar njohja;

1.5. Të ketë pajisje matëse dhe pajisje të tjera të nevojshme për të kryer detyrat për të cilat është kërkuar njohja, të kalibruara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.6. Të ketë protokoll për të kryer aktivitete për të cilat është kërkuar njohje;

1.7. Të ketë akreditim të vlefshëm në bazë të kërkesave të standardit të ISO 9001 dhe EN ISO/IEC 17025 për metodën e matjes që është e nevojshme në përputhje me nenin 4, për të kryer aktivitete profesionale të mbrojtjes nga rrezatimi, për të cilat kërkohet autorizimi.

Neni 7

Procedura e aplikimit për shërbim teknik

1. Për tu njohur si shërbim teknik, personat juridik duhet të plotësojnë:

1.1. Formularin për aplikim sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje;

1.2. Certifikatën për regjistrim të biznesit;

1.3. Lista e punëtorëve të cilët do të kryejnë detyrat profesionale të mbrojtjes nga rrezatimi me dëshmi të kualifikimit dhe përvojës së tyre;

1.4. Dëshmi për stafin të cilët punojnë dhe kryen matje të burimeve të rrezatimit për rrezatimin personal, mbikëqyrje mjekësore dhe trajnimi i veçantë profesional për përdorimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi;

1.5. Protokollet për detyrën të cilën kërkohet njohja;

1.6. Kopja e certifikatës të akreditimit me shtojca, sipas kërkesave të standardit EN ISO / IEC 17025 për metodat matëse që kërkohen për të kryer detyrat për të cilat është kërkuar autorizimi;

1.7. Deklaratën nën-betim;

1.8. Listën e pajisjeve me specifikacione teknik me të cilat kryen matjet, pajisjet laboratorike me të cilat kryen analizat dhe certifikatat e kalibrimit.

Neni 8

Procedura e aplikimit për shërbimet e mjekësisë së punës

1. Për tu njohur si shërbim i mjekësisë së punës, personat juridik duhet të plotësojnë:

- 1.1. Formularin për aplikim sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje ;
- 1.2. Certifikatën për regjistrim të biznesit;
- 1.3. Lista e punëtorëve profesional të cilët do të kryejnë detyrat profesionale shëndetësore;
- 1.4. Mbikëqyrjen mjekësore për punonjësit e ekspozuar;
- 1.5. Dëshmia e pajtueshmërisë me kushtet që lidhen me objektin/hapësira dhe pajisjet teknike;
- 1.6. Kopja e certifikatës të akreditimit me shtojca, sipas kërkesave të standardit EN ISO/IEC 17025 për metodat matëse që kërkohen për të kryer detyrat për të cilat është kërkuar autorizimi;
- 1.7. Deklaratën nën-betim;
- 1.8. Listën e pajisjeve me specifikacion teknik me të cilat kryhen kontrollet, pajisjet laboratorike me të cilat kryhen analizat dhe certifikatat e kalibrimit

Neni 9

Procedura e aplikimit për shërbimet e dozimetrisë

1. Për tu njohur si shërbim i dozimetrisë, personat juridik duhet të plotësojnë:
 - 1.1. Formularin për aplikim sipas Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. Certifikatën për regjistrim të biznesit;
 - 1.3. Lista e punëtorëve të cilët do të kryejnë detyrat profesionale për leximin dhe interpretimin e pajisjeve të monitorimit individual,
 - 1.4. Dëshmi për stafin të cilët punojnë dhe kryen matje të rrezatimit personal, dhe trajnimi i veçantë profesional për përdorimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi;
 - 1.5. Protokollet për detyrën të cilën kërkohet njohja;
 - 1.6. Kopja e certifikatës të akreditimit me shtojca, sipas kërkesave të standardit EN ISO / IEC 17025 për metodat matëse që kërkohen për të kryer detyrat për të cilat është kërkuar autorizimi;
 - 1.7. Deklaratën nën-betim;
 - 1.8. Listën e pajisjeve me specifikacion teknik me të cilat kryhen matjet dhe certifikatat e kalibrimit.

Neni 10

Regjistri i shërbimeve të njohura

1. Ministria, do të mbajë një regjistër të shërbimeve të njohura.
2. Shërbimet teknike, shërbimet e mjekësisë së punës dhe shërbimet e dozimetrisë do t'i raportojnë Ministrisë në lidhje me veprimtarinë sipas kushteve të njohjes.
3. Lista e shërbimeve të njohura do të publikohet në Web faqen e Ministrisë.

KAPITULLI III

NJOHJA E EKSPERTIT PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE EKSPERTIT TE FIZIKËS MJEKËSORE

Neni 11

Kriteret e përgjithshme

1. Kriteret e përgjithshme për ekspertët e mbrojtjes nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore janë si vijon:
 - 1.1. Të kenë njohuri për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, të përfituara nga edukimi formal, trajnimi specifik dhe përvoja e punës;
 - 1.2. Të kenë të zhvilluara attribute të larta personale, duke përfshirë aftësitë komunikuese, analitike dhe udhëheqëse;
 - 1.3. Të kenë njohuri të hollësishme për tema specifike që kanë të bëjnë me fushën e tyre të ekspertizës dhe në vazhdimësi duhet të kenë ngritje të njohurive në fushën e tyre të ekspertizës.

Neni 12

Eksperti për mbrojtje nga rrezatimi

1. Ministria siguron që eksperti i mbrojtjes nga rrezatimi i jep këshilla kompetente ndërmarrjes në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore për ekspozimin profesional dhe publik.
2. Këshilla e ekspertit për mbrojtje nga rrezatimi mbulon:
 - 2.1. Optimizimin dhe vendosjen e kufizimeve të përshtatshme të dozës;
 - 2.2. Planet për instalime të reja dhe pranimin në shërbim të burimeve të reja ose të modifikuara të rrezatimit në lidhje me çdo kontroll inxhinierie, karakteristika të projektimit, karakteristika të sigurisë dhe pajisjet paralajmëruese përkatëse të mbrojtjes nga rrezatimi;
 - 2.3. Kategorizimin e zonave të kontrolluara dhe të mbikëqyrura;
 - 2.4. Klasifikimin e punëtorëve të ekspozuar;
 - 2.5. Vendin e punës dhe programet individuale të monitorimit dhe dozimetritë personale;

- 2.6. Instrumentet të përshtatshme të monitorimit të rrezatimit;
 - 2.7. Kontrollin e cilësisë;
 - 2.8. Programin e monitorimit të mjedisit të punës;
 - 2.9. Masat për menaxhimin e mbetjeve radioaktive;
 - 2.10. Masat për parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve;
 - 2.11. Gatishmërinë dhe reagimin në situatë ekspozimit emergjent;
 - 2.12. Trajnimin dhe programet e rikualifikimit për punonjësit e ekspozuar;
 - 2.13. Hetimin dhe analizën e aksidenteve dhe incidenteve dhe veprimeve të duhura përmirësuese;
 - 2.14. Kushtet e punësimit për punonjëse shtatzëna dhe punonjëse që janë duke ushqyer me gji;
 - 2.15. Përgatitjen e dokumentacionit të duhur si vlerësimet e mëparshme të rrezikut dhe procedura të shkruara.
3. Kur është e nevojshme eksperti i mbrojtjes nga rrezatimi duhet, të mbajë lidhje me ekspertin e fizikës mjekësore.
4. Ekspertit të mbrojtjes nga rrezatimi mund t'i caktohet, nëse parashikohet në legjislationin në fuqi, detyrat e mbrojtjes nga rrezatimi të punonjësve dhe publikut.

Neni 13

Kriteret specifike për ekspertët për mbrojtjen nga rrezatimi

1. Për t'u njohur si ekspertë për mbrojtjes nga rrezatimi, aplikuesit duhet të demonstrojnë kompetencë në fushën e tyre të ekspertizës, duke marrë kualifikimin e duhur arsimor dhe aftësim në një (1) ose më shumë nga praktikat e mëposhtme:
- 1.1. Aplikimet mjekësore;
 - 1.2. Industria e përgjithshme;
 - 1.3. Transportin e materialeve radioaktive;
 - 1.4. Monitorimi dozimetrik i punonjësve;
 - 1.5. Edukimi i punonjësve profesional;

- 1.6. Monitorim të mjedisit;
 - 1.7. Menaxhimi, transporti, izolimi i mbetjeve radioaktive;
 - 1.8. Materialet radioaktive që ndodhen në natyrë;
 - 1.9. Praktikat në fushën e rrezatimit jo-jonizues.
2. Kompetenca për mbrojtje nga rrezatimi do të merret nëpërmjet kryerjes së studimeve në nivelin e diplomës universitare katër (4) vjeçare ose master në fizikë, kimi, inxhinieri elektrike dhe kompjuterike apo ekuivalent si dhe:
- 2.1. Kurs trajnimi pasuniversitar në mbrojtjen nga rrezatimi, duke përfshirë kurse që mbulojnë të gjitha specializimin e fushës e cila përfundon me një (1) certifikatë trajnimi nga një (1) shërbim teknik, institucion tjetër i akredituar brenda apo jashtë vendit;
 - 2.2. Përvojë pune e domosdoshme për një periudhë prej jo më pak se pesë (5) vjet në një praktikë që lidhet me specializimin për të cilin kërkohet njohja.
3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 nën paragrafi 2.1 të këtij neni aplikantët që mbajnë një diplomë doktrate si në paragrafin 1 të këtij neni përjashtohen nga trajnimi pasuniversitar në mbrojtjen nga rrezatimi.
4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 nën paragrafi 2.1 të këtij neni, mësimdhënësit e nivelit universitar që ofrojnë kurse për mbrojtje nga rrezatimi përjashtohen nga trajnimi pasuniversitar në mbrojtjen nga rrezatimi, me kusht që ata të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë pune.
5. Ekspertët e mbrojtjes nga rrezatimi duhet të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre profesionale duke marrë pjesë në aktivitete edukative dhe shkencore, duke përfshirë konferencat, simpoziume, kurse dhe punëtori, ofrimin e arsimimit dhe trajnimit në mbrojtjen nga rrezatimi, kontributet individuale në revista të specializuara ose në libra, botime dhe arbitrimin, ose pjesëmarrjen në zhvillimin e standardeve të sigurisë radiologjike, rregulloreve ose udhëzuesve.

Neni 14 **Eksperti i fizikës mjekësore**

1. Eksperti i fizikës mjekësore vepron ose duhet të japë mendimin si ekspert, sipas rastit për çështje që lidhen me fizikën e rrezatimeve duke zbatuar legjislacionin në fuqi.
2. Ministria siguron që në varësi të praktikës mjekësore, eksperti i fizikës mjekësore merr përgjegjësinë për dozimetrinë, duke përfshirë matjet fizike për vlerësimin e dozës që merr pacienti dhe individët e tjerë në varësi të ekspozimit mjekësor, si dhe të japë këshilla për pajisjet mjekësore radiologjike, dhe të kontribuojë në veçanti për:

- 2.1. Optimizimin e mbrojtjes nga rrezatimi të pacientëve dhe individëve të tjera në varësi të ekspozimit mjekësor, duke përfshirë aplikimin dhe përdorimin e niveleve të referencës diagnostike;
- 2.2. Përcaktimin dhe performancën e sigurimit të cilësisë së pajisjeve mjekësore radiologjike;
- 2.3. Testimin e pranimit të pajisjeve mjekësore radiologjike;
- 2.4. Përgatitjen e specifikimeve teknike për pajisje mjekësore radiologjike dhe projektimin e instalimeve;
- 2.5. Mbikëqyrjen e instalimeve mjekësore radiologjike;
- 2.6. Analizën e ngjarjeve që përfshijnë, ose potencialisht përfshijnë, ekspozime mjekësore aksidentale ose të paqëllimshme;
- 2.7. Zgjedhjen e pajisjeve të nevojshme për të kryer matje të mbrojtjes nga rrezatimi;
- 2.8. Trajnimin e profesionistëve dhe personelit tjetër në aspektet përkatëse të mbrojtjes nga rrezatimi.

Neni 15

Kushtet specifike për ekspertët e fizikës mjekësore

1. Për t'u njohur si ekspertë të fizikës mjekësore, aplikuesit duhet të demonstrojnë kompetencë në fushën e tyre të ekspertizës, duke marrë kualifikimin e duhur arsimor dhe aftësimin.
2. Diplomë universitare bachelor në fizikë, e ndjekur nga:
 - 2.1. Diplomë pasuniversitare në fizikë, që do të thotë diplomë master, ose ekuivalente;
 - 2.2. Certifikatën e trajnimit për ekspert të fizikës mjekësore në një shërbim teknik;
 - 2.3. Trajnim klinik i domosdoshëm për të paktën dy (2) vjet, në një institucion të kujdesit shëndetësor, nën mbikëqyrjen e një (1) eksperti të fizikës mjekësore të njohur nga Ministria.
 - 2.4. Trajnimi klinik shtese i domosdoshëm për secilin specializim në Radiologji, Mjekësi Nukleare dhe Onkologji do të kryhet me një periudhë jo më të shkurtër se gjashtë (6) muaj.
3. Ekspertët e fizikës mjekësore do të zhvillojnë më tej njohuritë dhe shkathtësitë e tyre profesionale, duke marrë pjesë në veprimtari edukative dhe shkencore, duke përfshirë konferencat, simpoziumet, kurset dhe seminarët, ofrimin e arsimimit dhe trajnimit të fizikanëve mjekësorë dhe profesionistëve të tjerë klinikë, ose kontributet individuale të specializuara revista ose libra, botime dhe referenca.

Neni 16

Njohja e ekspertëve

1. Për t'u njohur si ekspert për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspert i fizikës mjekësore, aplikantët duhet t'i paraqesin Ministrisë kërkesën e cila duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

1.1. Formularin përkatës të aplikimit nga Shtojca 1 e kësaj Rregullore;

1.2. Kopjen e letërnjoftimit;

1.3. Dëshminë se nuk ka ndjekje penale;

1.4. Kopjet e diplomave të studimeve;

1.5. Dëshmin për përvojën e punës;

1.6. CV/Rezymenë e punës;

1.7. Certifikatën e trajnimit për ekspertin për mbrojtjen nga rrezatimi ose ekspertin e fizikës mjekësore nga një shërbim teknik.

2. Punonjësit profesional të Ministrisë për sa kohë janë të punësuar në Ministri nuk kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e ekspertit.

Neni 17

Njohja e ekspertëve të jashtëm

1. Ekspertët e jashtëm për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertë të fizikës mjekësore të njohur si të tillë në vendet e BE-se dhe me vendet me të cilat Republika e Kosovës ka marrëveshje bilaterale njihen nga Ministria, me kusht që:

1.1. Janë njohur nga autoritetet kompetente të vendit të tyre të origjinës bazuar në kriteret e ngjashme të përshkruara në këtë Rregullore;

1.2. Ata e njohin legjislacionin dhe kuadrin rregullator që rregullon mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore të Republikës së Kosovës;

1.3. Nuk kanë ndjekje penale.

2. Me qëllim që të njihet si ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi ose eksperti i fizikës mjekësore në Republikën e Kosovës, aplikanti duhet të paraqesë në Ministri kërkesën e cila duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

2.1. Formularin e aplikimit të dhënë në Shtojcën 1, të plotësuar dhe të nënshkruar;

2.2. Kopjen e pasaportës;

2.3. Dëshminë se nuk ka ndjekje penale;

2.4. CV/Rezymenë e punës

2.5. Njohjen si ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi ose ekspert i fizikës mjekësore nga shteti i origjinës.

2.6. Përkthimi në gjuhën shqipe ose serbe i certifikatës së tyre të njohjes si ekspert i mbrojtjes nga rrezatimi ose ekspert i fizikës mjekësore të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit të tyre të origjinës i noterizuar;

3. Vendimi për njohjen e ekspertëve të jashtëm për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertëve të fizikës mjekësore merret nga Ministria në mënyrë të ngjashme siç është përshkruar në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.7 të paragrafi 1 të nenit 16 të kësaj Rregulloreje.

Neni 18

Kriteret specifike të njohjes së eksperteve

1. Njohja e ekspertit për mbrojtjen nga rrezatimi dhe ekspertit të fizikës mjekësore nuk mund të transferohen tek persona të tjerë.

2. Njohja për ekspert për mbrojtjen nga rrezatimi duhet t'i japin të drejtën mbajtësit për të kryer detyrat e përcaktuara në nenin 12 të kësaj Rregulloreje.

3. Njohja e ekspertit e fizikës mjekësore u japin të drejtën mbajtësit për të kryer detyrat e përcaktuara në nenin 14 të kësaj Rregulloreje.

4. Njohja nuk do t'i lirojë zotëruesit nga respektimi i të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të tjera në fuqi të Republikës së Kosovës, dhe në veçanti ligjet mbi punësimin e dyfishtë dhe konfliktin e interesit.

5. Njohja për ekspertët për mbrojtjen nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore do të kenë vlefshmëri deri në pese (5) vjet.

Neni 19

Ripërtëritja e njohjes së eksperteve

1. Vlefshmëria e njohjes për ekspertët e mbrojtjes nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore mund të vazhdohet sipas kërkesës.

2. Me qëllim të zgjatjes së vlefshmërisë së njohjes së tyre, aplikuesit duhet të dorëzojnë në Ministri kërkesën tridhjetë (30) ditë përpara datës së skadimit të njohjes, me dokumentet e mëposhtme:

2.1. Formularin përkatës të aplikimit nga Shtojca 1 e kësaj Rregullore, të plotësuar dhe të nënshkruar;

2.2. Dëshmi se nuk është në ndjekje penale;

2.3. Dëshminë që ekspertët për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore i kanë të paktën njëqind (100) pikë në total për pese (5) vitet e fundit, me një mesatare prej njëzet (20) pikësh në vit;

2.4. Piket e fituar do të llogariten që një (1) ditë trajnimi përkatës do të jetë e barasvlershme me dhjetë (10) pikë.

3. Pas vlerësimit, Komisioni do të lëshojë rekomandim ku shprehen gjetjet e tij dhe konkluzionet e vlerësimit të aplikacionit.

4. Bazuar në rekomandimin pozitiv të Komisionit, Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë do të zgjasë vlefshmërinë e certifikatës së njohjes për pesë (5) vite të tjera.

5. Bazuar në rekomandimin negativ të Komisionit, Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë do të lëshojë një vendim refuzimi për aplikantin, duke arsyetuar arsyet për refuzimin e aplikimit të tij.

Neni 20

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për njohje të shërbimeve teknike dhe eksperteve

1. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për njohje të shërbimeve teknike dhe eksperteve tani e tutje Komisioni formohet me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë në përbërje prej tre (3) anëtarëve.

2. Mandati i anëtarëve të komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni është një (1) vit me mundësi vazhdimi.

Neni 21

Detyrat e Komisionit

1. Komisioni shqyrton kërkesat, aplikacionin dhe dokumentacionin përcjellës të aplikuesit dhe përgatitë rekomandim për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë për plotësimin ose jo të kriterëve të përcaktuara në nenin 6 dhe 13 të kësaj Rregulloreje.

2. Pas dhënies së rekomandimit nga Komisioni, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë nxjerrë vendim për njohjen e shërbimeve teknike dhe eksperteve për të kryer detyra të caktuara teknike për mbrojtjen nga rrezatimi.

3. Në disa raste Komisioni realizon vizitë në teren për verifikimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje.

4. Komisioni bënë përpilimin e raportit vjetor dhe mban regjistër për çdo takim dhe çdo aplikacion të shqyrtuar gjatë mbledhjeve të Komisionit.

5. Komisioni do të vlerësojë kërkesën në afat prej tridhjetë (30) ditëve.

6. Në rast të kërkesave jo të plota, zyrtari përgjegjës do të kërkojë nga aplikanti që të dorëzojë dokumentet e munguara.
7. Në rast se aplikuesi nuk i dorëzon Ministrisë informatat që mungojnë në afat prej dyzetepesë (45) ditë pas pranimit të kërkesës për plotësimin e dokumenteve kërkesa refuzohet.
8. Aplikimet e plota do të vlerësohen për përputhshmëri me kriteret e njohjes të përshkruara në nenet 13 ose 15 të kësaj Rregulloreje, sipas rastit.
9. Bazuar në rekomandimin pozitiv të Komisionit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë lëshon certifikatën e njohjes të ekspertit, në formatin e dhënë në Shtojcën 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje.
10. Bazuar në rekomandimin negativ të Komisionit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë do të lëshojë Vendimin refuzues për aplikantin, duke arsyetuar refuzimin e aplikimit të tij.

Neni 22

Kohëzgjatja e njohjes

1. Njohja e referuar në nenin 6, të kësaj Rregulloreje, lëshohet për një periudhë të njëjtë me vlefshmërinë e certifikatës të akreditimit të kërkesave të EN ISO / IEC 17025 ose më së shumti për periudhë pesë (5) vjeçare.
2. Tre (3) muaj para skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, shërbimi teknik profesional duhet të aplikojë për rinjohje.

Neni 23

Revokimi dhe pezullimi i njohjes për shërbime dhe eksperteve

1. Ministria, do të revokoj njohjen për shërbimin e autorizuar teknik për të kryer detyra të caktuara teknike profesionale për mbrojtjen nga rrezatimi edhe para afatit të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje në rastet:
 - 1.1. Nëse brenda një kohe të caktuar nga vendimi për kontrollin inspektues shërbimi teknik profesional nuk rregullon mangësitë e identifikuara;
 - 1.2. Nëse inspektori vlerëson që një veprim apo praktikë është ushtruar duke shkelur këtë rregullore dhe paraqet rrezik lëndimi të menjëhershëm ose dëm të konsiderueshëm të shëndetit, pronës ose mjedisit;
 - 1.3. Nëse trupi akreditues që ka lëshuar akreditimin e referuar në nenin 7, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.6 e kësaj rregulloreje tërheq akreditimin.
 - 1.4. Në rast të keqpërdorimit të njohjes si: tjetërsimi, falsifikimi i dokumentit të ekspertizës.

2. Ministria, do të pezullojë njohjen për shërbimin e autorizuar teknik për të kryer detyra të caktuara teknike profesionale për mbrojtjen nga rrezatimi edhe para afatit të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje në rastet:

2.1. Nëse inspektimi konstaton se veprimet e shërbimit teknik profesional nuk janë në pajtim me kushtet e përcaktuara në njohje;

3. Në rast të pezullimit të akreditimit nga trupi akreditues që ka lëshuar akreditimin e përmendur në nenin 7, paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të kësaj Rregulloreje, shërbimi teknik i njohur nuk mund të kryej detyrat profesionale të mbrojtjes nga rrezatimi, gjatë periudhës së vlefshmërisë së pezullimit, në fushën e akreditimit i cili është pezulluar përkohësisht.

Neni 24 **Refuzimi i kërkesës**

Refuzimi i kërkesës për njohjen e shërbimeve teknike profesionale bëhet kur konstatohet që nuk janë plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 6, 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI IV **EDUKIMI DHE TRAJNIMI**

Neni 25 **Edukimi dhe trajnimi**

1. Çdo ndërmarrje duhet të ofroj edukim, trajnim dhe informacion të duhur për mbrojtje nga rrezatimi për individët detyrat e të cilëve kërkojnë kompetenca specifike në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.

2. Punonjësit të cilët duhet t'i nënshtrohen edukimit dhe trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi janë:

2.1. Punonjësit e ekspozuar;

2.2. Punonjësit potencialisht të ekspozuar nga burimet jetime;

2.3. Punonjësit emergjent;

2.4. Punonjësit dhe ekspertet në fushën e ekspozimit mjekësor;

2.5. Punonjësit e Ministrisë.

3. Trajnimet duhet të jenë periodike brenda periudhës pesë (5) vjeçare.

4. Ministria në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike tani e tutje IKAP hartojnë programin e trajnimit me module specifike i cili program është Shtojca 1 e kësaj Rregulloreje.

Neni 26

Kategoritë e personave që duhet të trajnohen

1. Gjatë zhvillimit të kurseve të trajnimit duhet pasur parasysh fakti që shpesh shkalla e përgatitjes së pjesëmarrësve nuk është e njëjtë sa i përket njohurive bazë. Megjithatë, trajnimi është i nevojshëm dhe gjatë përcaktimit të përmbajtjes së programit, duke marr parasysh ato çështje që kanë lidhje direkte me fushën e zbatimit të rrezatimit nga pjesëmarrësit. Përcaktimi dhe vendosja e një niveli bazë të kompetencës është çështje me prioritet të lartë për të gjithë personelin.
2. Ministria do të përkrah procedurat që të vendosin në vend një kulturë të lartë sigurie. Kjo arrihet vetëm në rastin kur të gjithë personat që përdorin burime të rrezatimeve të jenë trajnuar në mënyrë të përshtatshme për të kuptuar sa më drejt përgjegjësitë që kanë dhe kryerjen e detyrave në kushtet e një sigurie të lartë.
3. Kategoritë e personave që duhet të trajnohen janë:
 - 3.1. Ekspertët për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore;
 - 3.2. Zyrtarët për mbrojtjen nga rrezatimi;
 - 3.3. Punonjësit që përdorin burimet e rrezatimit;
 - 3.4. Punonjësit e Departamentit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.
4. Përmbajtja dhe niveli i trajnimit për secilën nga këto kategori bazohen në faktorë të tillë si: mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimeve, niveli i supervizimit të veprimtarisë, kompleksiteti i punës që do të kryhet si dhe shkalla e trajnimeve të mëparshme të punonjësit.

Neni 27

Institucionet që kryejnë trajnimin e punonjësve

1. Institucionet që kryejnë trajnimin e punonjësve për mbrojtjen nga rrezatimi duhet të kenë stafin pedagogjik-ekspert të përshtatshëm për kryerjen e trajnimit, i cili duhet të dëshmojë përgatitjen e tij, si dhe bazën e nevojshme materiale për zhvillimin e kurseve.
2. Këtu institucione mund të jenë departamente pranë universiteteve, shërbim teknik, IKAP por gjithmonë të njohura nga Ministria.

Neni 28

Ri trajnimi

Punonjësit që përdorin burime të rrezatimit dhe që kanë marr trajnimin përkatës për mbrojtjen nga rrezatimet, duhet të i nënshtrohen kurseve të ri trajnimit pas një periudhe prej pesë (5) vjetësh.

Neni 29

Vlerësimi dhe njohja e trajnimit

1. Në fundin e kursit të trajnimit si rregull duhet të bëhet një vlerësim i njohurive të fituara,

nëpërmjet testimit të pjesëmarrësve i monitoruar nga DMRrSB.

2. Pas përfundimit të kursit të trajnimit dhe vlerësimit të kryer, pjesëmarrësit duhet të pajisen me një certifikate. Certifikata duhet të përmbajë emërtimin e qendrës trajnuese, titullin e kursit të trajnimit si dhe kohën e zhvillimit të tij. Certifikata nënshkruhet nga autoritetet drejtuese të kursit.

Neni 30 Shtojcat

1. Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë:

1.1. Shtojca 1 – Formularët për Aplikim;

1.2. Shtojca 2 - Programi i Trajnimit në fushën e Mbrojtjes nga Rrezatimi

1.3. Shtojca 3 - Sillabusi themelor për kurset e mbrojtjes nga rrezatimet;

1.4. Shtojca 4 - Sillabuset specifike të kursit;

1.5. Shtojca 5 - Sillabusi i trajnimit për personat përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet; dhe

1.6. Shtojca 6 - Sillabusi i trajnimit për ekspertët për mbrojtje nga rrezatimi dhe ekspertët e fizikës mjekësore.

KAPITULLI V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 31 Dispozitat kalimtare

Nën paragrafi 1.7 i paragrafi 1 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje fillon te zbatohet tri (3) vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 32 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

30 gusht 2024

SHTOJCA 1
FORMULARET PER APLIKIM



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore

APLIKACIONI PËR NJOHJEN E SHËRBIMEVE

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT:

Personi juridik:	Të dhënat e kontaktit: Tel: E-mail:
Qyteti:	Kodi postar:
Rruga dhe numri:	

2. LISTA E PRAKTIKAVE PËR TË CILAT KËRKOHEJ NJOHJA:

Sherbimi teknik <input type="checkbox"/>	Shërbimi i mjekesisë së punës <input type="checkbox"/>	Shërbimi i dozimetrisë <input type="checkbox"/>
Radiologji diagnostike – intervenuese	<input type="checkbox"/>	Radiografi industriale <input type="checkbox"/>
Radioterapi/Onkologji	<input type="checkbox"/>	Teknika të njehësimit <input type="checkbox"/>
Mjekësi Bërthamore	<input type="checkbox"/>	Teknika të hapjes së puseve <input type="checkbox"/>
Kontrolli sistematik shendetesore	<input type="checkbox"/>	Menaxhim i burimeve dhe mbetjeve radioaktive/berthamore dhe dekomisionim <input type="checkbox"/>
Edukimi dhe trajnimi	<input type="checkbox"/>	Transport te burimeve dhe materialeve radioaktive <input type="checkbox"/>
Matja e perqendrimit te radonit	<input type="checkbox"/>	Kalibrimin dhe leximin e pajisjeve të monitorimit individual <input type="checkbox"/>
Matjet dhe monitorimi i aktivitetit të substancave radioaktive në ajër, tokë, ujë	<input type="checkbox"/>	Ekspertiza e burimeve te rrezatimit jo-jonizues <input type="checkbox"/>
Kontrollimi i skrap metalit per qellime transport-eksporti	<input type="checkbox"/>	Të tjera (specifiko): <input type="checkbox"/>

3.LISTA E DOKUMENTACIONIT PER NJOHJE SI EKSPERT PER MBROTJE NGA RREZATIMI:

- Çertifikata e biznesit ARBK
- Dëshminë nga gjykata se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale
- Listën e pajisjeve me të cilat kryen matjet dhe certifikatat e kalibrimit.
- Lista e punëtorëve të cilët do të kryejnë detyrat profesionale me dëshmi të kualifikimit dhe përvojës së tyre
- Deklarata nën betim
- Dokumente shtese (specifiko): _____

4.VERIFIKIMI I PERSONIT JURIDIK

V.V.

Data: ____/____/____

Te dhënat personale te aplikuesit do te trajtohen ne perputhje me Ligjin per mbrojtjen e te dhenave personale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore

APLIKACIONI PËR NJOHJEN E EKSPERTËVE PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT:

Emri dhe mbiemri:	Të dhënat e kontaktit: Tel: E-mail:
Qyteti:	Kodi postar:
Rruga dhe numri:	

2. LISTA E PRAKTIKAVE PËR TË CILAT KËRROHET NJOHJA:

Mjekësi:		Industri dhe te tjera:	
Radiologji diagnostike	<input type="checkbox"/>	Radiografi industriale	<input type="checkbox"/>
Radiologji intervenuese	<input type="checkbox"/>	Teknika të njehësimit	<input type="checkbox"/>
Mjekësi Bërthamore	<input type="checkbox"/>	Teknika të hapjes së puseve	<input type="checkbox"/>
Radioterapi/Onkologji	<input type="checkbox"/>	Menaxhim të mbetjeve radioaktive dhe dekomisionim	<input type="checkbox"/>
Te tjera (specifiko):	<input type="checkbox"/>	Të tjera (specifiko):	<input type="checkbox"/>

3. LISTA E DOKUMENTACIONIT PER NJOHJE SI EKSPERT PER MBROTJE NGA RREZATIMI:

- Një kopje të letërnjoftimit
- Kopje të diplomave të studimeve
- Dëshmi për përvojën e punës jo më pak se pesë vjet në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi ose siguri bërthamore
- Dëshminë nga gjykata se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale
- CV/Rezymenë e punës
- Çertifikatën e trajnimit për ekspertin për mbrojtjen nga rrezatimi
- Deklarata nën betim
- Dokumente shtese (specifiko): _____

4. VERIFIKIMI I PERSONIT JURIDIK :

Emri mbiemri dhe nënshkrimi: _____ v.v. Data: _____

Te dhënat personale te aplikuesit do te trajtohen ne perputhje me Ligjin per mbrojtjen e te dhenave personale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore

APLIKACIONI PËR NJOHJEN E EKSPERTËVE TË FIZIKËS MJEKËSORE

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT:

Emri dhe mbiemri:	Të dhënat e kontaktit: Tel: E-mail:
Qyteti:	Kodi postar:
Rruga dhe numri:	

2.LISTA E PRAKTIKAVE PËR TË CILAT KËRROHET NJOHJA:

Mjekësi:	
Radiologji diagnostike	<input type="checkbox"/>
Radiologji intervenuese	<input type="checkbox"/>
Mjekësi Bërthamore	<input type="checkbox"/>
Radioterapi/Onkologji	<input type="checkbox"/>
Te tjera (specifiko):	<input type="checkbox"/>

3.LISTA E DOKUMENTACIONIT PER NJOHJE SI EKSPERT I FIZIKËS MJEKËSORE:

- Një kopje të letërnjoftimit
- Kopje të diplomave të studimeve
- Dëshmi për përvojën e punës
- Dëshminë nga gjykata se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale
- CV/Rezymenë e punës
- Çertifikatën e trajnimit për ekspertin e fizikes mjekesore
- Deklarata nën betim
- Dokumente shtese (*specifiko*): _____

4.VERIFIKIMI I PERSONIT JURIDIK :

Emri mbiemri dhe nënshkrimi: _____ v.v. Data: _____
Te dhënat personale te aplikuesit do te trajtohen ne perputhje me Ligjin per mbrojtjen e te dhenave personale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore

APLIKACIONI PËR NJOHJEN E EKSPERTËVE TË JASHEM PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE EKSPERTËVE TË FIZIKËS MJEKËSORE

1. TË DHËNAT E APLIKUESIT:

Emri dhe mbiemri:	Të dhënat e kontaktit:	
	Tel:	
	E-mail:	
Qyteti:	Kodi postar:	
Rruga dhe numri:		

2. LISTA E PRAKTIKAVE PËR TË CILAT KËRKOHEJ NJOHJA:

Mjekësi:		Industri dhe te tjera:	
Radiologji diagnostike	<input type="checkbox"/>	Radiografi industriale	<input type="checkbox"/>
Radiologji intervenuese	<input type="checkbox"/>	Teknika të njehësimit	<input type="checkbox"/>
Mjekësi Bërthamore	<input type="checkbox"/>	Teknika të hapjes së puseve	<input type="checkbox"/>
Radioterapi/Onkologji	<input type="checkbox"/>	Menaxhim të mbetjeve radioaktive dhe dekomisionim	<input type="checkbox"/>
Te tjera (specifiko):	<input type="checkbox"/>	Të tjera (specifiko):	<input type="checkbox"/>

3. LISTA E DOKUMENTACIONIT PER NJOHJE SI EKSPERT PER MBROTJE NGA RREZATIMI:

- Një kopje të Pasaportës
- Njohjen si Ekspert i Mbrojtjes nga Rrezatimi ose Ekspert i Fizikës Mjekësore nga shteti i origjinës
- Noterizimi i certifikatës si Ekspert i Mbrojtjes nga Rrezatimi ose Ekspert i Fizikës Mjekësore të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës;
- CV/Rezumenë e punës
- Dëshminë nga gjykata se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale
- Deklarata nën betim
- Dokumente shtese (specifiko): _____

4. VERIFIKIMI I PERSONIT JURIDIK :

Emri mbiemri dhe nënshkrimi: _____ v.v. Data: _____

Te dhënat personale te aplikuesit do te trajtohen ne perputhje me Ligjin per mbrojtjen e te dhenave personale.

SHTOJCA 2

PROGRAMI I TRAJNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES NGA RREZATIMI

Mbështetur në nenin 11 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore dhe Rregullores Nr.24/2018 për Autorizime, Ministria miraton programin për trajnimin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Ministria përmes dokumentit themelor në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet sigurisë dhe sigurimit, shtron si detyrë parësore që “ të identifikohen në mënyrë të qartë përgjegjësitë e çdo individ, duke përfshirë edhe nivelet e larta menaxhuese, për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet si dhe çdo individ të jetë trajnuar dhe kualifikuar në mënyrë të përshtatshme”.

Ky dokument shtron gjithashtu si detyrë që “Ministria të sigurojë përgatitjen e një kuadri ligjor adekuat, që kërkon trajnimin e përshtatshëm për të gjithë personelin e angazhuar nëveprimtari që lidhen me sigurinë e rrezatimeve dhe sigurimin fizik të burimeve të rrezatimeve”.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, del si detyrë që çdo person, i cili ekspozohet profesionalisht ndaj rrezatimeve ose që mund t’u ekspozohet rrezatimeve gjatë punës së tij, duhet të trajnohet në mënyrë të përshtatshme për mbrojtjen nga rrezatimi dhe për përdorimin e sigurt të burimeve të rrezatimeve. Trajnimi duhet të lidhet me praktika specifike dhe mund të variojë nga një kurs i shkurtër një (1) ditë për mbrojtje nga rrezatimet deri në një (1) kurs ekstensiv disa mujor për një (1) ekspert të kualifikuar.

Në këto kushte Ministria miraton programin e mëposhtëm të trajnimit të punonjësve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi duke përfshirë përgatitjen e programeve të posaçme për personat që duhet të trajnohen duke mbajtur parasysh shkallën e arsimimit, eksperiencën në punë, kualifikimin etj.

1.1. Eksperti për mbrojtje nga rrezatimi dhe eksperti i fizikës mjekësore

Trajnimi për ekspertin e kualifikuar duhet të sigurojë një njohje të gjerë të mbrojtjes nga rrezatimet, sigurisë së rrezatimeve dhe sigurimit fizik të burimeve radioaktive. Ky nivel njohurish mund të fitohet me arsimim të rregullt, me trajnim të posaçëm dhe me eksperiencë pune. Për më tepër, eksperti i kualifikuar duhet të ketë një njohje të gjithanshme të shumë çështjeve specifike që lidhen me fushat e tij të ekspertizës si dhe duhet të jetë në dijeni të zhvillimeve në këto fusha.

Eksperti i kualifikuar duhet të ketë cilësi personale të spikatura, duke përfshirë komunikimin, aftësi analitike dhe udhëheqëse, mbasi ata udhëheqin trajnime dhe japin këshilla për një gamë të gjerë punonjësish si tekniket, menaxheret, specialistët dhe autoritetet qeveritare.

Kurset për trajnimin e eksperteve të kualifikuar si rregull duhet të jenë tre (3) muaj.

1.2. Zyrtari për mbrojtjen nga rrezatimi

Trajnimi për përgjegjësit për mbrojtjen nga rrezatimet do të varet shumë nga fusha e zbatimit të rrezatimeve, por të gjitha trajnimet duhet të përmbajnë një sasi të caktuar të informacioneve bazë të mbrojtjes dhe sigurisë. Thellësia e mbulimit të çdo çështjeje do të varet nga praktikat specifike në të cilën personi është trajnuar dhe duhet të mbajë parasysh madhësinë e rrezikut potencial që lidhet me praktikën e zbatuar.

Zyrtari për mbrojtjen nga rrezatimi duhet të zotërojë cilësi personale, kurset për trajnimin e përgjegjësit për

mbrojtjen nga rrezatimet si rregull duhet të jenë tri (3) javë.

1.3. Punonjësi që përdor burimet e rrezatimit

Punonjësit që janë të ekspozuar ndaj rrezatimit, për shkak të profesionit të tyre, kanë nevojë për trajnim të rregullt lidhur me masat mbrojtëse nga rrezatimi. Trajnimi mund të variojë nga trajnim një (1) ditë i punonjësit në afërsi të një (1) sonde të thjeshtë radioaktive që shërben p.sh. për matjen e nivelit (nivelmatës), deri në trajnim prej një ose më shumë javësh për punonjës të një (1) impianti rrezatues.

Trajnimi i punonjësve për problemet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë duhet të jetë pjesë përbërëse kryesore e çdo programi të mbrojtjes nga rrezatimi. Trajnimi duhet të kryhet në përputhje me llojin e punës dhe me llojin e zbatimit të burimeve të rrezatimit. Ai duhet të krijojë tek punonjësit shprehitë e nevojshme për të realizuar kurdoherë një punë të sigurt me burimet e rrezatimit. Programi i trajnimit duhet të garantojë që punonjësit të marrin informacione adekuate dhe të përditësuara për rreziqet shëndetësore që lidhen me ekspozimin profesional, ekspozimin aksidental dhe për rëndësinë që ka marrja e masave mbrojtëse. Trajnimi duhet të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve për respektimin e masave mbrojtëse në vendet e punës. Po ashtu punonjëset e moshës riprodhuese duhet të kenë informacionin e nevojshëm lidhur me rrezikun potencial të rrezatimeve ndaj embrionit ose fetusit gjatë shtatzënisë.

Kurset për trajnimin e punonjësve që përdorin burime të rrezatimeve, si rregull duhet të jenë (3-4) tri deri në katër ditë.

1.4. Punonjësit e Departamentit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Trajnimi i punonjësve të DMRrSB do të varet nga detyrat që ata kryejnë dhe nga rreziku radiologjik potencial i burimeve të rrezatimeve që ata inspektojnë. Kështu, punonjësit, që përfshihen në vlerësimin e sigurisë së rrezatimeve dhe në inspektimet e institucioneve që përdorin burime të ndryshme të rrezatimeve duhet të kalojnë në trajnime të gjata, ndërkohë që një inspektor i sondave industriale duhet të ketë një trajnim bazë për mbrojtjen nga rrezatimet. Punonjësit e departamentit duhet të kenë njohuri për standardet dhe praktikën rregullatore që zbatohen në vendet e zhvilluara, komponentë ,të rëndësishme, të trajnimit të punonjësve janë monitorimi i rrezatimeve dhe teknikat e inspektimit. Gjatë zhvillimit të trajnimit duhet të stimulohen cilësitë personale të punonjësve të trupit rregullator si komunikimi, analizimi dhe menaxhimi. Kurset për trajnimin e punonjësve të trupit rregullator si rregull duhet të jenë disa ditore (3-4 ditë) ose më të gjata ,duke mbajtur parasysh kërkesat specifike për specialiste të veçantë.

2. Ri trajnimi

Kjo është e nevojshme për të rifreskuar njohuritë e fituara në kursin paraardhës të trajnimit, si dhe për t'u njohur me zhvillimet e reja të mundshme në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet. Kurset e ri trajnimit si rregull zhvillohen mbi bazën e të njëjtit program me ato të kurseve të trajnimit, por, sikurse u theksua më lart, duke mbajtur parasysh si zhvillimet e reja, ashtu dhe faktin që punonjësit tashmë kanë fituar një eksperiencë pune me burimet e rrezatimeve që kanë në përdorim.

3. Sillabuset e kurseve për mbrojtjen nga rrezatimi

Sillabuset e kurseve të trajnimit përmbajnë një sillabus themelor, i cili shërben për përvetësimin e bazave të mbrojtjes nga rrezatimet për të gjithë punonjësit, ose specialistet, si dhe një sillabus shtesë (te posaçëm), i cili përmban çështje që lidhen me specialitete të veçanta që janë:

- Radiodiagnostika,
- Radioterapia (teleterapi dhe brakiterapi),
- Mjekësia bërthamore,

- Radiografia industriale.
- Përdorimi i sondave radioaktive
- Punonjësit e Departamentit

SHTOJCA 3

SILLABUSI THEMELOR PËR KURSET E MBROJTJES NGA RREZATIMET

<p>1. Hyrje ne fiziken atomike dhe bërthamore Atomi dhe bërthama. Radioaktiviteti Llojet e rrezatimeve te zbërthimeve bërthamore Radioaktiviteti natyror dhe artificial</p>	1 orë
<p>2. Bashkëveprimi i rrezatimeve me lëndën Rrezatimi direkt dhe indirekt Bashkëveprimi i grimcave të ngarkuara me lëndën Bashkëveprimi i rrezatimeve elektromagnetike me lëndën</p>	1 orë
<p>3. Madhësitë dhe njësite matëse dozimetrike Aktiviteti, doza e përthithur, doza e ekspozimit Llogaritja e dozës nga një burim pikësor</p>	1 orë
<p>4. Efektet biologjike të rrezatimeve Veprimi direkt dhe indirekt i rrezatimeve Efektet stokastike dhe deterministike Ekspozimi i jashtëm dhe ekspozimi i brendshëm Doza ekuivalente</p>	1 orë
<p>5. Standardet e mbrojtjes nga rrezatimet Parimet bazë të mbrojtjes nga rrezatimet Nivelet natyrore të rrezatimeve Llojet e ekspozimeve dhe standardet e tyre Kategorizimi i burimeve radioaktive Siguria dhe sigurimi fizik i burimeve Infrastruktura e mbrojtjes nga rrezatimet Nivelet e përjashtimit</p>	1 orë
<p>6. Aparatet matëse të rrezatimeve Aparatet matëse me detektor gazore Aparatet matëse me detektor shintilues Kalibrimi i aparateve matëse të rrezatimit Aparatet matëse të dozave</p>	1 orë
<p>7. Mbrojtja nga rrezatimet Mbrojtja nga rrezatimi alfa dhe beta Mbrojtja nga rrezatimi gama Mbrojtja nga rrezatimi neutronik Mbrojtja nga rrezet X Pajisjet dhe mjetet mbrojtëse nga rrezatimet Rregullat e punës me burime te rrezatimeve</p>	2 orë

Pune praktike	2 orë
Matja e rrezatimeve	
Mbrojtja ngas rrezatimet	
Zgjatje totale e kursit:	10 orë

SHTOJCA 4

SILLABUSET SPECIFIKE TË KURSIT

1. Radiologjia diagnostikuese **3 orë**

Prodhimi i rrezeve X, tubat e rrezeve X, parametrat e punës, filtrimi dhe diafragmimi itufës se rrezeve X
 Radiografia, fluoroskopia, mamografia, radiologjia intervenuese, tomografia e kompjuterizuar, (CT Skaner), radiologjia dentare
 Pajisjet dhe mjetet mbrojtëse: përparëset, dorezat, syzet etj,
 Monitorimi i zonave të kontrolluara dhe monitorimi individual.
 Sigurimi i cilësisë (QA) dhe kontrolli i cilësisë (QC)
 Mbrojtja e pacienteve dhe e publikut (nivelet udhëzuese, dozat kufi)

2. Radioterapia (teleterapia dhe brakiterapia) **3 orë**

Burimet e rrezatimeve (Co-60, Ir-192), dalja e burimeve të rrezatimeve
 Akseleratorët lineare
 Makinat e kobaltit dhe të brakiterapise
 Kolimatorët, dhomat e jonizimit,
 Aparatet e tomografise se kompjuterizuar (CT Skaner)
 Monitorimi i zonave dhe monitorimi individual
 Sigurimi i cilësisë (QA) dhe kontrolli i cilësisë (QC)
 Sigurimi fizik i burimeve, testet e rrjedhjes se burimeve radioaktive
 Planifikimi i emergjencave

3. Mjekësia bërthamore **3 orë**

Burimet radioaktive që përdoren, cilësitë, gjeneratorët izotopik,
 Kamerat gama, skanerat, SPECT, PET
 Kalibratorët, aparatet matëse dhe kontrolluese të rrezatimit
 Monitorimi i zonave dhe monitorimi individual (i jashtëm, i brendshëm, ndotjetradioaktive)
 Sigurimi i cilësisë (QA) dhe kontrolli i cilësisë (QC)
 Pajisjet dhe mjetet mbrojtëse
 Sigurimi fizik i burimeve, aksidentet dhe emergjencat.
 Procedurat e pastrimit të ndotjeve radioaktive. Trajtimi i mbetjeve radioaktive

4. Radiografia industriale **3 orë**

Burimet gama që përdoren në radiografinë industriale, makinat e rrezeve X.
 Mjediset rrezatuese, mbrojtja e tyre.
 Përgatitja dhe shënjimi i zonave të rrezatimit në terren, sistemet e paralajmërimit
 Zgjedhja e vendeve për rrezatim
 Sigurimi fizik i burimeve radioaktive
 Monitorimi i zonave dhe monitorimi individual
 Sigurimi cilësisë (QA) dhe kontrolli i cilësisë (QC)

Emergjencat gjate transportit dhe rrezatimit te objekteve
Trajtimi i mbetjeve radioaktive

5. Përdorimi i sondave radioaktive dhe karrotazhit radioaktiv **3 orë**

Llojet e sondave radioaktive (matësit e trashësisë, densitetit, nivelit, lagështisë etj.)
Sondat fikse dhe sondat e lëvizëse
Mjetet e kontrollit te puseve te shpimit – karrotazhi radioaktiv
Vendosja dhe ruajtja e burimeve te sondave, sigurimi fizik i tyre
Transporti i burimeve radioaktive
Testimi i rrjedhjes se burimeve
Trajtimi i mbetjeve radioaktive
Sigurimi i cilësisë (QA) dhe kontrolli i cilësisë (QC)
Monitorimi i zonave dhe monitorimi individual
Aksidentet dhe emergjencat e rrezatimeve

6. Punonjës i trupit rregullator **3 orë**

Kuadri rregullator, infrastruktura e mbrojtjes nga rrezatimet
Radiografia, fluoroskopia, mamografia, radiologjia intervenuese, tomografia e kompjuterizuar, (CT Skaner), radiologjia dentare
Makinat e telekobaltit dhe te brakiterapise
Burimet gama dhe makinat e rrezeve X qe përdoren ne radiografinë industriale
Llojet e sondave radioaktive
Trajtimi i mbetjeve radioaktive
Monitorimi i zonave dhe monitorimi individual
Aksidentet dhe emergjencat e rrezatimeve.

SHTOJCA 5

SILLABUSI I TRAJNIMIT PËR PERSONAT PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET

1. Bazat e fizikës bërthamore **5 orë**

Hyrje në strukturën atomike Radioaktiviteti
Bashkëveprimi i rrezatimeve me lëndën Burimet e rrezatimeve

2. Madhësitë dhe njësit e dozimetrike **2 orë**

Aktiviteti, doza e përthithur, doza e ekspozimit

3.Llojet e praktikave me rrezatime **2 orë**

Sondat radioaktive
Radiografia industriale
Përdorimet në mjekësi

4.Efektet biologjike të rrezatimeve **2 orë**

Efektet deterministike

Efektet stokastike
Doza ekuivalente

5. Parimet e mbrojtjes nga rrezatimet dhe kuadri nderkombetar i standardeve (BSS) 2 orë

Kuadri konceptual i mbrojtjes nga rrezatimet
Organizatata ndërkombetare të specializuara

6. Infrastruktura e mbrojtjes nga rrezatimet 3 orë

Sistemi rregullator
Programi i mbrojtjes nga rrezatimet
Kultura e sigurisë, sigurimi i cilësisë, trajnimi

7. Mbrojtja operacionale ndaj rrezatimeve 6 orë

Aspekte teknike të mbrojtjes nga rrezatimet
Siguria dhe sigurimi fizik i burimeve
Klasifikimi i zonave
Monitorimi i vendeve të punës

8. Vlerësimi i ekspozimeve të brendshme dhe të jashtme 3 orë

Trajtimi i mbetjeve radioaktive
Monitorimi individual
Kontrolli shëndetësor

9. Transporti i materialeve radioaktive 1 orë

Kategoritë e transportit
Llojet e paketimeve, etiketimi

10. Përgatitja dhe reagimi ndaj emergjencave 1 orë

Plani kombëtar i emergjencave
Planet e emergjencave të organizatave

PRAKTIKA:

- | | |
|--|--------------|
| 1. Radiometria e rrezatimeve | 4 orë |
| 2. Dozimetria termolumineshente | 4 orë |
| 3. Monitorimi zonave | 4 orë |
| 4. Llogaritja e dozave dhe e mbrojtjes nga rrezatimet | 4 orë |
| 5. Menaxhimi i mbetjeve radioaktive | 4 orë |
| 6. Kalibrimi i aparateve dozimetrike | 4 orë |

Zgjatje totale e kualifikimit: 51 orë

SHTOJCA 6

SILLABUSI I TRAJNIMIT PËR EKSPERTËT PËR MBROJTJE NGA RREZATIMI DHE EKSPERTËT E FIZIKËS MJEKESORE

- | | |
|---|-----------------|
| 1. Bazat e fizikës atomike dhe bërthamore | 1 javë |
| Njohuri bazë të thelluara në fizikën atomike dhe bërthamore | |
| 2. Madhësitë themelore dozimetrike dhe njësit e tyre matëse | 1 javë |
| 3. Njohuri te thelluara për madhësitë dozimetrike dhe njësite e tyre si dhe llogaritjet e tyre. | |
| Njohuri për detektorët e rrezatimeve dhe karakteristikat e tyre të punës.
Zgjedhja e detektoreve të përshtatshëm për matjet një fushë të dhënë rrezatimesh. | |
| 4. Efektet biologjike të rrezatimeve | 0,5 javë |
| Mekanizmat e veprimit të rrezatimeve në indete gjalla, llojet e efekteve, doza ekuivalente, dëmtimet dhe koeficientet e risqeve për vlerësimin e dëmtimeve | |
| 5. Parimet e mbrojtjes nga rrezatimet dhe kuadri ligjor | 1 javë |
| Kuadri konceptual, parimet dhe standardet ndërkombëtare të mbrojtjes nga rrezatimet Për llogaritja e trashësive mbrojtëse | |
| 6. Kontrolli rregullator | 1 javë |
| Njohja me kërkesat e infrastrukturës rregullatore për mbrojtjen nga rrezatimet dhe sigurinë e rrezatimeve | |
| 7. Vlerësimi i ekspozimeve të jashtme dhe të brendshme | 2 javë |
| Vlerësimi i dozave të krijuara nga ekspozimet ebrendshme dhe të jashtme | |
| 8. Mbrojtja nga ekspozimet profesionale | 2 javë |
| Hartimi dhe zbatimi praktik i një programitë mbrojtjes nga rrezatimet për ekspozimet profesionale | |
| 9. Ekspozimet mjekësore në diagnostike, radioterapi dhe mjekësi bërthamore | 1,5 javë |
| Zbatimi i parimeve të mbrojtjes nga rrezatimet në ekspozimet mjekësore.
(radiologji diagnostikuese dhe intervenuese, radioterapi dhe mjekësi bërthamore)
Llogaritja e dozave te pacienteve. | |
| 10. Ekspozimet publike nga praktikat me burime të rrezatimeve | 1 javë |
| Njohja e rrugëve të ndryshme, nëpërmjet të cilave mund të ekspozohet publiku si rezultat i praktikave, si dhe metodat për përcaktimin e dozave | |
| 11. Emergjencat radiologjike, përgatitja dhe reagimi ndaj tyre | 1 javë |

Njohja me shkaqet dhe pasojat e situatave të ekspozimeve kronike dhe të aksidenteve radiologjike dhe bërthamore, si dhe veprimet për likuidimin e pasojave të emergjencave

12. Trajnimi i trajnuesve

1 javë

Organizimi dhe zhvillimi i kurseve të trajnimit.

Zhvillimi i aftësive didaktike

Zgjatja totale e kualifikimit: